



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

PROCESVERBAL

Nr. 463 Prot.

Sot, më datë 03.02.2021, ditën e mërkurë, ora 13.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare jashtë rradhe në platformën online, të thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mbledh në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Z. Gent Ibrahimi
2. Z. Alfred Balla
3. Z. Bujar Sheshi
4. Znj. Esmeralda Keshi
5. Znj. Eloida Goxhi
6. Z. Kostaq Beluri
7. Z. Moisi Duda
8. Znj. Nurihan Seiti
9. Z. Sandër Beci
10. Z. Tartar Bazaj
11. Z. Vatë Staka

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projektet OPDAT, EURALIUS dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Gent Ibrahimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorimit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

Rendi i ditës:

1.Hedhja e shortit për përcaktimin e relatorit në procedurat e levizjeve paralele për pozicionet e shpallura sipas njoftimit të datës 30 dhjetor 2020 në faqen zyrtare të Këshillit.



Z. Ibrahim shprehet se, kjo është një mbledhje tjetër jashtë rradhës, e cila diktohet nga Vendimi që mori Këshilli në mbledhjen e një dite më parë, përmes të cilit u miratua lista e kandidatëve zyrtarë për procedurat e lëvizjes paralele të shpallura në datën 30.12.2020. Z. Ibrahim sqaron se, në vijim të atij vendimi është i nevojshëm dhe caktimi i relatorit për shqyrtimin e aplikimeve të këtyre prokurorëve për lëvizjen paralele. Sipas rregullores, Këshilli ka vendosur që relatorët do të caktohen mbi bazë pozicioni dhe jo mbi bazë kandidati, dhe duke qwnw se ka 21 pozicione gjithsej, Këshillit do ti duhet që të caktojë 21 relatorë. Këto detyra dhe do të ndahen midis tre anëtarëve të Komisionit të Karrierës, siç e parashikon dhe Rregullorja (ku relator nuk mund të jetë tjetër përveçse anëtarët e këtij Komisioni). Duke qënë se ka 21 procedura të lëvizjes paralele, secili prej tyre do të shërbejë si relator në shtatë procedura.

Znj. Seiti i kujton Këshillit ardhjen e dy anëtarëve të rinj dhe shtron pyetjen nëse fillimisht duhet të procedohej me ndarjen e prokurorëve të rinj në komisione.

Z. Ibrahim përfiton nga rasti për t'i uruar mirëseardhjen dy anëtarëve të sapozgjedhur, znj. Eloida Goxhi dhe z. Moisi Duda. Ai kujton që anëtarët e rinj automatikisht i përkasin komisioneve në të cilat ishin pjesë anëtarët që ata kanë zëvendësuar, dhe përkatësisht z. Moisi Duda kalon tek Komisioni për Zhvillimin e Karrierës dhe znj. Eloida Goxha tek Komisioni për Disiplinën.

Z. Ibrahim i fton tre anëtarët e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës për të hedhur shortin, z. Sandwr Beci, z. Moisi Duda dhe z. Vatë Staka. Ai sqaron mënyrën se si do të hidhet shorti.

Znj. Seiti kërkon sqarime, nëse procedura konsiston që një anëtar do të relatojë për të gjithë aplikantët e një pozicioni. Znj. Seiti i referohet listës, ku të njëjtët magjistratë konkurojnë për shembull dhe tek pozicioni 1, tek pozicioni 2 dhe tek pozicioni 3.

Z. Ibrahim përgjigjet se, kjo është një vështirësi të cilën Këshilli nuk e shmang dot. Ai sqaron se Këshilli vendosi që ta lehtësojë procesin duke vendosur një relator për çdo procedurë dhe jo për çdo kandidat, pasi do të ishte e vështirë që të krahasosh kandidatët.

Z. Balla përfiton nga rasti që ti urojë mirëseardhjen dy anëtarëve të rinj dhe propozon Këshillit të organizojë një ceremoni modeste që ti urojë mirëseardhjen atyre.

Z. Bazaj i uron suksese dy anëtarëve të rinj të Këshillit.

Fillon procedura e hedhjes së shortit sipas rradhës së përcaktuar në Komisionin e Karrierës, me ndihmën e z. Fabjon Murrizi, dhe rezultati i shortit është si më poshtë,



Relatori	Pozicioni
1. Z. Moisi Duda	Pozicioni vakant nr.1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shpallur me Vendimi nr. 319, datë 29.12.2020.
2. Z. Sandër Beci	Pozicioni nr. 2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shpallur me Vendimin nr. 320, datë 29.12.2020
3. Z. Vatë Staka	Pozicioni nr. 3 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shpallur me Vendimin nr. 321 datë 29.12.2020.
4. Z. Sandër Beci	Pozicioni nr. 4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, shpallur me Vendimin nr. 322 datë 29.12.2020.
5. Z. Moisi Duda	Pozicioni nr. 5 në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr.323, datë 29.12.2020.
6. Z. Vatë Staka	Pozicioni nr. 6 në Prokurorinë e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr.324, datë 29.12.2020.
7. Z. Vatë Staka	Pozicioni nr. 1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës shpallur me Vendimin nr.327, datë 29.12.2020.
8. Z. Moisi Duda	Pozicioni nr. 2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës shpallur me Vendimin nr.328, datë 29.12.2020.
9. Z. Sandër Beci	Pozicioni nr. 3 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës shpallur me Vendimin nr.329, datë 29.12.2020.
10. Z. Sandër Beci	Pozicioni nr. 1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, shpallur me Vendimin nr.341, datë 29.12.2020.
11. Z. Moisi Duda	Pozicioni nr. 2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, shpallur me Vendimin nr.342, datë 29.12.2020.
12. Z. Vatë Staka	Pozicioni nr. 3 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, shpallur me Vendimin nr.343, datë 29.12.2020.
13. Z. Vatë Staka	Pozicioni nr. 1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, shpallur me Vendimin nr.330, datë 29.12.2020.
14. Z. Moisi Duda	Pozicioni nr. 2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, shpallur me Vendimin nr.331, datë 29.12.2020.
15. Z. Sandër Beci	Pozicioni nr. 3 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, shpallur me Vendimin nr.332, datë 29.12.2020.



- | | | |
|-----|----------------|---|
| 16. | Z. Moisi Duda | Pozicioni nr.1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, shpallur me Vendimin nr. 325, datë 29.12.2020 |
| 17. | Z. Sandër Beci | Pozicioni nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, shpallur me Vendimin nr. 326, datë 29.12.2020. |
| 18. | Z. Vatë Staka | Pozicion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, i shpallur me Vendimin nr. 333, datë 29.12.2020. |
| 19. | Z. Sandër Beci | Pozicion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, shpallur me Vendimin nr. 334, datë 29.12.2020. |
| 20. | Z. Vatë Staka | Pozicion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, shpallur me Vendimin nr. 337 Lushnje datë 29.12.2020. |
| 21. | Z. Moisi Duda | Pozicion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, shpallur me Vendimin nr. 339, datë 29.12.2020. |

Z. Ibrahim hedh në votim projektvendimin për përcaktimin e relatorit në procedurat e levizjeve paralele për pozicionet e shpallura sipas njoftimit të datës 30 dhjetor 2020, sipas shortit që sapo u hodh.


Miratohet me 9 vota pro. Të gjithë janë dakord.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit)

Z. Ibrahim falënderon anëtarët për diskutimet e tyre dhe në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit
Sonila Çeliku

KRYETARI
Gent Ibrahim



Shënim 1:

Në këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. ___ Datë ___ 2021/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. ___ datë ___ (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 12/03/2021

Procesverbali të arkivohet.

PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Frederik Sulisufi